

DOWN  
SYNDROME  
KOSOVA

**uni** Universum  
International College  
Powered by Arizona State University

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Marrëveshje e lidhur në mes të:

Shoqatës Down Syndrome Kosova, përfaqësuar nga Sebahate Beqiri, me seli në, Rr. Gursel e Bajram Sylejmani " Ferizaj

dhe

Universum International College, me seli në Magjistrалja Prishtinë- Ferizaj, përfaqësuar nga Alejtin Berisha, President.

Palët pajtohen si më poshtë:

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit është përcaktimi i termeve dhe kushteve të bashkëpunimit në mes të Shoqatës Down Syndrome Kosova dhe Universum International College.

### Neni 2 Fushëveprimi i bashkëpunimit të palëve

Palët shprehin gatishmërinë dhe bien dakord që të kenë bashkëpunim në fushat si në vijim:

1. Ofrimin e programeve të praktikës/ intershipit për studentët e Universum International College në Down Syndrome Kosova.
2. Palët do të angazhohen për krijimin e kushteve më të mira, të cilat do të avancojnë zhvillimin njerëzor nëpërmjet krijimit të mundësive për të rinjtë dhe hapjen e mundësive për studentë për të mbaruar praktikën e punës në njësitë organizative të kompanive.
3. Kolegji Universum, partnerit të kësaj marrëveshjeje, do t'i dorëzojë listën e studenteve përzgjedhur për mbajtjen e praktikës në DSK.
4. Kolegji do të ofroj kurse të gjuhës angleze për anëtarët me sindromën Down.
5. Puna praktika e studentëve të Kolegjit në organizatë, do të aplikohet varësisht nga zhvillimet dhe nevojat e shoqatës për një angazhim të tillë.
6. Studentëve do t'u kërkohen dokumentacionet sipas procedurave që ka organizata.

**Neni 3**  
**Marrëveshja rreth kontributeve të ndërsjella në mes të palëve**

Palët në marrëveshje dakordohen rreth bashkëpunimit dhe kontributit të tyre.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Palët janë dakorduar që kohëzgjatja e marrëveshjes të mos jetë e kufizuar.

**Neni 5**  
**Mospajtimet dhe paqartësitë**

1. Secila palë nënshkruese e marrëveshjes mund ta ndërprerë marrëveshjen brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit me shkrim, nëse pala tjetër nuk është në gjendje apo në ndonjë mënyrë pengohet në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të veta sipas marrëveshjes, duke vënë në rrezik arritjen e objektivave të projektit, me kusht që palët janë konsultuar, por pa sukses në përpjekje për të eliminuar pengesën.
2. Pas njoftimit për ndërprerje, siç përcaktohen në paragrafin e 1 të këtij neni, palët menjëherë marrin hapat e nevojshëm për të finalizuar aktivitetet e tyre sipas marrëveshjes, duke e bërë këtë sa më shpejtë dhe në mënyrë të organizuar me qëllim të minimizimit të humbjeve dhe shpenzimeve shtesë.

**Neni 6**  
**Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast se në mes të palëve të kësaj Marrëveshjeje, paraqiten paqartësi, mos pajtime apo për ndonjë arsye tjetër, do të zgjidhen përmes bisedimeve.
2. Nëse tentativat për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve nuk kanë sukses, secila nga palët mund t'a ndërpresë këtë Marrëveshje. Njoftimi për ndërprerjen e Marrëveshjes duhet t'i dërgohet palës tjetër me shkrim, së paku një muaj para ndërprerjes efektive të saj.

**Neni 7**  
**Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj**


1. Çdo ndryshim eventual i kësaj marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe hynë në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshje.
2. Secila nga palët mund të tërhiqet brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit me shkrim.
3. Kohë e paralajmërimit do të merret data e pranimit të letrës paralajmëruese.

**Neni 8**  
**Hyrja në Fuqi**

1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet më datën 31 / 05 / 2024, në Prishtinë, Republika e Kosovës, në dy (2) ekzemplar origjinale, nga një për së cilën palë nënshkruese.

**PALET NËNSHKRUESE**

UNIVERSUM INTERNATIONAL  
COLLEGE

per   
Drejtori



SHOQATËN DOWN SYNDROME KOSOVA  
Sebahate Beqiri

per   
Drejtoreshë Ekzekutive

